



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

-SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM-

Në bazë të nenit 7 të Vendimit për formimin e Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit civil ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 98/16 dhe 164/17 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 97/19), Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

**RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË dhe THIRRJE
PUBLIKE PËR VOTIM
për zgjedhjen e 16 anëtarëve të Këshillit për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Sektorit Civil nga
radhët e shoqatave dhe fondacioneve**

I. RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË

Në bazë të Thirrjes Publike për zgjedhjen e 16 anëtarëve të Këshillit për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Sektorit Civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve, publikuarmë 22 Mars të vitit 2021, në faqet e internetit www.vlada.mk dhe www.nvosorabotka.gov.mk, në afatin e paraparë (5.4.2021) kanë arritur fletëparaqitje për 26 kandidatë. Fletëparaqitja e Metamorfozisë, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Shkup ka arritur në mënyrë elektronike.

Nuk është i plotë dokumentacioni i: Shoqatës së qytetarëve - Shoqata për Sigurinë e Korporatave, Sundimi isë Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut MENAXHER PËR SIGURI KORPORATIVE Shkup (nuk është dorëzuar ekzemplar i Gjendjes aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, Statutit, Llogarisë përfundimtare për vitin 2020 Raport për punën me qëllimet, aktivitetet, rezultatet dhe burimet e financimit në tre vitet e fundit, Biografi dhe letër motivimi të kandidatit), Shoqatës Instituti i Sociologjisë SHOQRIA E MIRË Tetovë (nuk është dorëzuar ekzemplar i Gjendjes aktualenga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerëve juridikë për regjistrimin e organizatës dhe Llogarisë përfundimtare për vitin 2020), Shoqatës për Turizmin Alternativ Ballkanik - Ballkanija Shkup (nuk është dorëzuar ekzemplar i Llogarisë përfundimtare për vitin paraprak (2020), por për vitin 2019) dhe Metamofozisë, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri Shkup (nuk është dorëzuar Raport për punën me qëllime, aktivitete, rezultate dhe burime të financimit në tre vitet e fundit).

Gjatë verifikimit administrativ të fletëparaqitjeve u përcaktua se fletëparaqitjet e shoqatave dhe fondacioneve në vijim i plotësojnë kushtet e Thirrjes Publike: Fondacioni Shoqëria e Hapur, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Organizata Aleanca Rinore Tetovë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut Shkup, Shoqata për Hulumtime dhe Analiza ZMAI Shkup, Shoqata Konekt Shkup, Shoqata e Punonjësve të Arsimit të Qytetit të Shkupit, Shkup, Fondacioni për Nisma Arsimore dhe Kulturore ÇEKOR PO ÇEKOR Shkup, Shoqata Organizata Multietnike për Kultura Ndërkombëtare Mozaik-Meik Shkup, Shoqata e Qytetarëve Forumi Rinor Arsimor Shkup, Kualicionii

Organizatave Rinore SEGA, Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave, Shkup, Shoqata e Personave me Paralizë Cerebrale dhe Aftësi të tjera të Kufizuara Veles, Koalicioni të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara MARGINI Shkup, Shoqata për Barazi Gjinore EDNA MOZHE Shkup, Shoqata për Avancimin e Barazisë Gjinore Akcija Združenska Shkup, Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që Jetojnë me HIV –ZAEDNO POSILLNI Shkup, Shoqata e Qytetarëve Qendra për Zhvillim Bujqësor EKO PRODUKT Tetovë, Fondacioni për Afirmim dhe Prezantim Kulturor dhe Shkencor Maqedonia prezent - Shkup, JADRO - Shoqata e Skenës së Pavarur Kulturore , Shoqata e Qytetarëve për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor EKOZVON Shkup dhe Shoqata e Qytetarëve FORUMI RINOR PËR BASHKËPUNIM Shkup.

II. THIRRJE PUBLIKE PËR VOTIM

për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve

Thirren të gjitha organizatat aktive të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. të japin votën e tyre **vetëm për një kandidat, në fushën që është identike me fushën e veprimtë organizatës, në përputhje me statutin e saj.**

Organizatrat nuk votojnë për kandidatin nga organizata e tyre.

Votimi kryhet duke plotësuar **Formularin e Votimit**, të disponueshëm në lidhjen vijuese www.nvosorabotka.gov.mk dhe duke dorëzuar ekzemplar të **gjendjes aktualenga** regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës.

Sindikatat e regjistruara në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet plotësojnë një formular votimi, që llogaritet për një votë të dhënë.

Organizatrat mund të mbështesin vetëm një kandidat nga **Lista e Kandidatëve** në vijim.

Numri	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Emri i shoqatës/ fondacionit që propozon kandidat	Biografia dhe letër motivimi
1. Zhvillim i sektorit civil			
32-19/1	Fani Karanfillova Panovska	Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedonia Shkup.	
2. Demokraci dhe sundim të së drejtës			
32-21/1	Snezhana Kamillovska Trpovska	Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar Shkup	
32-35/1	Nebojsa Zaharieski	Organizata Aleanca Rinore Tetovë	
3. Promovim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe antidiskriminim			
32-27/1	Urani Pirovska	Shoqata Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë Shkup	
4. Zhvillim ekonomik dhe të qëndrueshëm			
32-25/1	Viktor Mitevski	Shoqata për Hulumtime dhe Analiza-ZMAI Shkup	
32-32/1	Nikica Kusinikova	Shoqata Konekt Shkup	

5. Shkencë, Arsim dhe Të mësuarit gjatë gjithë jetës			
32-12/1	Katerina Mitkovska	Shoqata e punonjësve të Arsimit të Qytetit të Shkupit, Shkup	
32-20/1	Suzana Kiranxhiska	Fondacioni për Nisma Arsimore dhe Kulturore ÇEKOR PO ÇEKOR Shkup	
32-23/1	Dragica Kostadinovska	Shoqata Organizata Multietnike për Kultura Ndërkombëtare Mozaik-Meik Shkup	
32-30/1	Dimitar Nizamovski	Shoqata e Qytetarëve Forumi Rinor Arsimor Shkup	
6. Të Rinjtë			
32-33/1	Zoran Ilieski	Kualicioni i Organizatave Rinore Sega Prilep	
7. Mbrojtje sociale dhe mbrojtje e fëmijëve			
32-15/1	Jasminka Frishçiq	Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave, Shkup	
8. Mbrojtje e personave të marginalizuar			
32-14/1	Daliborka Zllateva	Shoqata e Personave me Paralizë Cerebrale dhe Aftësi të tjera të Kufizuara Veles	
32-18/1	Natasha Boshkova	Koalicioni të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara MARGINI Shkup	
9. Barazi gjinore			
32-24/1	Doroti Pačkova	Shoqata për Barazi Gjinore EDNA MOZHE Shkup	
32-26/1	Tatjana Stoimenovska	Shoqata për Avancimin e Barazisë Gjinore Akcija Zdruzhenska Shkup	
10. Mbrojtje e shëndetit			
32-28/1	Andrej Senih	Shoqata për Mbështetjen e Njerëzve që Jetojnë me HIV – ZAEDNO POSILLNI Shkup	
11. Bujqësi dhe zhvillim rural			
32-34/1	Nesim Velu	Shoqata e Qytetarëve Qendra për Zhvillim Bujqësor EKO PRODUKT Tetovë	
12. Kulturë			
32-10/1	Hristo Petreski	Fondacioni për Afirmim dhe Prezantim Kulturor dhe Shkencor Maqedonia prezent - Shkup	
32-31/1	Tijana Ana Spasovska	Jadro Shoqata e Skenës së Pavarur Kulturore	
13. Media dhe shoqëria informatike			
	Kandidati i paraqitur ka dokumentacion jo të plotë		
14. Mbrojtje e mjedisit jetësor			
32-17/1	Sllagjana Stamenkova	Shoqata e Qytetarëve për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor EKOZVON Shkup	

15.Sport			
	Nuk ka kandidatë të paraqitur		
16.Politikat e BE-së dhe integrimet			
32-22/1	Oliver Romevski	Shoqata e Qytetarëve FORUMI RINOR PËR BASHKËPUNIM Shkup	

Për vota të pavlefshme do të llogariten votat e organizatave që nuk janë **aktive** në përputhje me gjendjen aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, si dhe votat e organizatave që kanë votuar në fushën e veprimtimit që nuk është paraparë në statutin e tyre.

Afati i votimit është deri më 29 Prill viti 2021.

Formulari i plotësuar i votimit i nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës dhe i verifikuar me vulën e saj, me ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, duhet të dorëzohen përmes postës në adresën:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sekretariati i Përgjithshëm
Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare
bul. “ Ilinden” nr.2
1000 Shkup

me shënimin: "Mbështetje për kandidat për anëtar të Këshillit".
ose **të skanuara** të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën: nvosorabotka@gs.gov.mk.

Në afat prej 8 ditëve pas përfundimit të votimit, Sekretariati i Përgjithshëm - Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në faqen e internetit www.nvosorabotka.gov.mk do të publikojë Listën e kandidatëve sipas numrit të votave të marra për secilën nga fushat e veprimtimit. Nëse për ndonjë nga fushat e veprimtimit nuk paraqiten kandidatë ose asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara, përsëro do të përcaktohet thirrje publike për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve, vetëm për atë fushë të veprimtimit.

Në rast kur ka dy ose më shumë kandidatë të renditur në radhë të parë, votimi do të përsëritet vetëm në atë fushë më së voni 15 ditë nga publikimi i Listës së Kandidatëve.